

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikafloor®-3240

SISTEM I VETËNIVELUESHËM DYSHEMEJE PUR ME 2 PËRBËRËS, ELASTIK-I FORTË DHE ME PËRMBAJTJE TË ULËT LIDHJESH ORGANIKE FLURORE (VOC)

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikafloor®-3240 është rrëshirë e vetënivelueshme PUR e ngjyrosur me 2 përbërës, pa tretës dhe me përmbajtje të plotë solidesh sipas Deutsche Bauchemie dhe veti elastike të forta. Sikafloor®-3240 përdor teknologjinë unike i-Cure të Sika-s për përmirësimin e estetikës së sipërfaqes dhe reduktimin e ndjeshmërisë ndaj lagështisë së ambientit gjatë aplikimit.

PËRDORIMET

Sikafloor®-3240 duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

- Shtresë konsumimi e lëmuar për mbylljen e plasaritjeve të dysHEMEVE industriale në mjedise prodhimi, magazinimi, punishte, etj.
- Shtresë konsumimi e spërkatur me rërë për mbylljen e plasaritjeve në zona punimesh të lagështa (industria ushqimore & pijeve, etj.), vende parkimi automjete, rampa ngarkimi, etj.
- Aplikohet mbi sipërfaqe asfalti, mjedise të brendshme, qendra tregtare, zona ekspozimi & magazinimi.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Fleksibilitet dhe elasticitet i fortë
- Mbyllje e plasaritjeve
- Është i mundur aplikimi mbi nënshtresat asfaltike
- Rezistencë e mirë kimike dhe mekanike
- Pa tretës dhe çlirime të ulëta VOC
- Mundësi për sipërfaqe me rezistencë ndaj rrëshqitjes
- Aplikim dhe pastrim i lehtë
- Produkt ekonomik
- Pa ndjeshmëri ndaj lagështisë

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

Pajtueshmëri me LEED v2009 IEQc 4.2: Materiale me çlirime të ulëta - Bojëra & veshje

MIRATIME / STANDARDE

- Llaç prej rrëshirë sintetike sipas EN 13813:2002, certifikuar nga organi i njoftuar i kontrollit të prodhimit në fabrikë, mbart markën CE
- Veshje për mbrojtjen e betonit sipas EN 1504-2:2004, certifikuar nga organi i njoftuar i kontrollit të prodhimit në fabrikë, mbart markën CE
- Testim çlirimesh sipas skemës gjermane AgBB dhe udhëzimet e DiBT (AgBB - Komiteti për Vlerësimin rreth Shëndetit për Produktet e Ndërtimit, DiBT - Instituti Gjerman për Teknologjinë e Ndërtimit). Marrja e mostrave, testimi dhe vlerësimi u kryen sipas ISO-16000, Raport Nr. 392-2015-00212801_D_DE_02, Testimi Eurofins i Produktit Testing A/S, Danimarkë.
- Klasifikimi në zjarr sipas DIN EN 13501-1:2010-01: Raport Nr. 20150909/01, MPA Dresden
- Certifikatë për çlirimin e gazeve VOC: Cleanroom Suitable Materials - CSM. Deklaratë Kualifikimi, ISO-AMCm kategoria - 6.9. Testuar nga IPA raport nr. SI 1506-767.
- Kategoria e Rezistencës Biologjike "E mirë" - Materiale të përshtatshme për shomat me higjienë të lartë. Vlerësimi i rezistencës biologjike sipas ISO 846. Testuar nga IPA raport nr. SI 1506-767.
- Testi Riboflavin sipas ISO 4628-1 dhe VDI 2083-17: Shkëlqyeshëm. Testuar në Fraunhofer IPA raport testimi SI 1506-767.
- Pajtueshmëria me bojërat sipas PV 3.10.7 testuar në HQM Induserv Germany, raport testimi 15-08-15203573-001.
- Vetë për mbylljen e plasaritjeve sipas EN 1062-7 metoda A, Raport testimi Nr: 51-15-0056, IBOS GmbH.
- Kategoria e rezistencës ndaj rrëshqitjes e përcaktuar sipas DIN 51131, raporte testimi 020109-15-16,

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Poliuretan (PUR)	
Ambalazhi	Përbërësi A	kovë 20.25 kg
	Përbërësi B	kovë 4.75 kg
	Përbërësit A+B	njësi 25.0 kg gati për përzierje
Paraqitja / Ngjyra	Përbërësi A	lëng me ngjyrë
	Përbërësi B	lëng transparent
Sikafloor®-3240 disponohet në shumëllojshmëri ngjyrash.		
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit	
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C.	
Dendësia	Përbërësi A	~1.4 kg/l (DIN EN ISO 2811-1)
	Përbërësi B	~1.3 kg/l
	Rrëshira e përzierë (e mbushur 1:0.5)	~1.6 kg/l
	Mbushja 1:0.5 me rrërë kuarci F34 0.1–0.3 mm. Të gjitha vlerat e dendësisë në +23 °C.	
Përmbajtja e substancave të ngurta		
Përmbajtja e substancave të ngurta për ~100 % peshë		
Përmbajtja e substancave të ngurta për ~100 % vëllim		
TË DHËNA TEKNIKE		
Fortësia Shore D	~ 60 (7 ditë / 23°C / 50% lagështi relative)	(DIN 53505)
Rezistenca ndaj abrazionit	~ 65 mg (14 ditë / 23°C / 50% lagështi relative)	(ASTM D 4060)
Rezistenca ndaj tërheqjes	~ 14 N/mm ² (14 ditë / 23°C / 50% lagështi relative)	(DIN EN ISO 527-2)
Zgjatimi deri në thyerje	~ 90 % (rrëshirë / 28 ditë / +23°C / 50% lagështi relative)	(ISO 527-2)
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	>1.5 N/mm ² (dështim betoni)	(EN 13892-8)
Rezistenca kimike	Rezistencë ndaj shumë kimikateve. Kontaktoni me shërbimin teknik për informacione specifike.	

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Sistemet	Ju lutemi referohuni në skedën teknike të sistemit të:	
	Sikafloor® MultiFlex PS-32	Veshje PUR për dysheme, e lëmuar, me ngjyrë të njëtrajtshme, elastike-e fortë
	Sikafloor® MultiFlex PS-32 UV	Veshje PUR për dysheme, e lëmuar, me ngjyrë të njëtrajtshme, elastike-e fortë, me izolim ndaj UV
	Sikafloor® MultiFlex PB-32	Veshje PUR për dysheme, e lëmuar, me ngjyrë të njëtrajtshme, elastike-e fortë, me spërkatje rëre
	Sikafloor® MultiFlex PB-32 UV	Veshje PUR për dysheme, e lëmuar, me ngjyrë të njëtrajtshme, elastike-e fortë, me spërkatje rëre dhe izolim ndaj UV

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	Përbërësi A : Përbërësi B = 81 : 19 (për peshë)			
Konsumimi	Ju lutemi referohuni në skedën teknike të sistemit përkatës.			
Temperatura e mjedisit	+10 °C min. / +30 °C max.			
Lagështia relative e ajrit	~ 75 - 80 %			
Pika e vesës	Kujdes kondensimin! Nënshtrësja dhe dyshemeja e patharë duhet të jenë të paktën 3°C mbi pikën e vesës për të reduktuar rrezikun e kondensimit ose çngjyrosjes mbi dyshemenë përfundimtare.			
Temperatura e nënshtrësës	+10 °C min. / +30 °C max.			
Lagështia e përmbajtjes së nënshtrësës	< 4 % pjesë për peshë përmbajtje lagështie. Metoda e testimit: matësi Sika®-Tramex, matja CM ose metoda e tharjes në furrë. Pa rritje të lagështisë sipas ASTM (fletë polietilene).			
Koha e punueshmërisë	Temperaturat	Koha		
	+10 °C	~ 40 minuta		
	+20 °C	~ 30 minuta		
	+30 °C	~ 20 minuta		
Koha e maturimit	Përpara mbiveshjes së Sikafloor®-3240 lini:			
	Temperatura e nënshtrësës	Min.	Max.	
	+10 °C	~ 30 orë	~ 72 orë	
	+20 °C	~ 24 orë	~ 48 orë	
+30 °C	~ 16 orë	~ 36 orë		
<small>Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të mjedisit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative. Nëse tejkalohej koha max. e pritjes, sipërfaqja e Sikafloor®-3240 duhet të smerilozohet për të pasur ngjitje mekanike midis shtresave të Sikafloor®.</small>				
Produkti i aplikuar gati për përdorim	Temperatura	Qarkullim këmbësorësh	Qarkullim i lehtë	Tharja e plotë
	+10 °C	1 ditë	3 ditë	9 ditë
	+20 °C	12 orë	2 ditë	5 ditë
	+30 °C	8 orë	1 ditë	3 ditë
<small>Shënim: Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të ambientit.</small>				

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Sipërfaqja duhet të jetë e pastër, e thatë dhe pa ndotës si pislëqet, vaj apo graso, veshje dhe trajtime të sipërfaqes, etj. Pluhuri, materiali i lirë dhe i shpërbërë duhet të hiqet nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të produktit, preferohet me vakuum. Rezistenca ndaj tërheqjes nuk duhet të jetë më pak se 1.5 N/mm². Në rast dyshimi aplikoni më parë mbi një zonë për provë.

PËRZIERJA

Përpara përzierjes, trazoni mekanikisht përbërësin A. Kur i gjithë përbërësi B të jetë shtuar tek përbërësi A, përzieni vazhdimisht për 2 minuta derisa të përftohet një miks homogjen. Kur përbërësit A dhe B të jenë përzierë, shtoni rërën e kuarcit F34 0.1 – 0.3 mm dhe përzieni edhe për 2 minuta derisa të arrihet një miks homogjen. Për të siguruar përzierjen e plotë, hidhini materialet brenda një kove tjetër dhe përzieni sërish derisa të arrihet një miks konsistent. Pas përzierjes,

lëreni miksin të ndërveprojë për 3 minuta përpara aplikimit.

Veglat e përzierjes

Sikafloor®-3240 duhet të përzihet plotësisht me një mikser elektrik në shpejtësi të ulët (300 - 400 rpm) ose pajisje tjetër të përshtatshme.

APLIKIMI

Përpara aplikimit, konfirmoni lagështinë e përmbajtjes së nënshtrësës, lagështinë relative dhe pikën e vesës. Sikafloor®-3240 derdhet dhe përhapet në mënyrë të njëtrajtshme me mallë të dhembëzuar ose krëhër. Kur përdoret në sistem të vetënivelueshëm, kaloni në 2 drejtime rulin me gjemba për të siguruar trashësinë e njëtrajtshme dhe largimin e ajrit të bllokuar.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me Thinner C menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar dhe/ose i tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

MIRËMBAJTJA

PASTRIMI

Për të ruajtur paraqitjen e dyshemesë pas aplikimit, duhet të largohen menjëherë të gjitha rrjedhjet nga Sikafloor®-3240 dhe të pastrohet rregullisht me furçë rrotulluese, pastrues mekanik, aparat tharjeje, pastrues me presion të lartë, teknika pastrimi dhe vakuumi, etj. duke përdorur detergjentët dhe dyllin e përshtatshëm.

DOKUMENTA SHITESË

Cilësia & përgatitja e nënshtresës

Ju lutemi referohuni tek Sika Method Statement: "VLERËSIMI & PËRGATITJA E SIPËRFAQEVE PËR SISTEMET E DYSHEMEVE".

Udhëzime aplikimi

Ju lutemi referohuni tek Sika Method Statement: "PËRZIERJA & APLIKIMI I SISTEMEVE TË DYSHEMEVE".

Mirëmbajtja

Ju lutemi referohuni tek "Sikafloor® - REGJIMI I PASTRIMIT".

KUFIZIME

- Ndryshimet në ngjyrë janë të pashmangshme për shkak të lëndëve të para. Mund të ndodhë me rërën e kuarcit në ngjyrat e ndezura si e verdhë ose portokalli ku ndryshimet në ngjyrë për shkak të sfondit në ngjyrë të hapur mund të jenë të dukshme. Me këto ngjyra, patejdukshmëria është e kufizuar nëse produkti përdoret si veshje përfundimtare. Rekomandohet aplikimi mbi një zonë për referencë.
- Në rrezatim UV dhe ndryshimet e motit është i mundur ndryshimi në ngjyrë. Për përputhje të ngjyrës, sigurohuni se Sikafloor®-3240 përbërësit A dhe B janë aplikuar nga i njëjti numër serie prodhimi.
- Mos aplikoni Sikafloor®-3240 mbi nënshtresa me lagështi në rritje.
- Mos aplikoni mbi nënshtresa sipërfaqesh me pjerrësi > 1 %.
- Sikafloor®-3240 i freskët duhet të mbrohet nga lagështia, kondensimi dhe uji për të paktën 24 orë. Materiali i patharë reagon në kontakt me ujin (shkumëzim). Gjatë aplikimit duhet të kujdeseni që të mos pikojë djersë mbi Sikafloor®-3240 e freskët. (vendosni shirit në kokë dhe në duar).
- Vlerësimi dhe trajtimi i gabuar i plasaritjeve mund të çojë në kohë të reduktuar shërbimi dhe plasaritje reflektive.
- Për aplikimet e lëmuara me ekspozim në rrezatim diellor, përdorni si veshje izoluese Sikafloor®-357 N ose Sikafloor®-305W.
- Në kushte të caktuara, ngrohja nëndysheme ose temperaturat e larta të ambientit të kombinuara me ngarkesat pikësore të mëdha, mund të lëjnë shenja në rrëshirë.
- Nëse gjatë aplikimit, nevojitet ngrohje mos përdorni gaz, vaj, vajguri apo ngrohës me lëndë djegëse fosile të tjera, këto prodhojnë sasi të mëdha CO₂ dhe avujsh uji H₂O, të cilët mund të ndikojnë negativisht tek sipërfaqja përfundimtare. Për ngrohje përdorni vetëm sisteme elektrike ventilimi ajri të ngrohtë.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas Udhëzimit të BE 2004/42, përmbytja max. e lejuar e VOC (Kategori produkti IIA / j lloji sb) është 500 g/l (Kufizimet 2010) për produktin gati për përdorim.

Përmbytja max. e Sikafloor®-3240 është < 500 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikafloor®-3240

Qershor 2019, Botimi 02.01

020812040020000008

Sikafloor-3240-sq-AL-(06-2019)-2-1.pdf